



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 03, datë 21.01.2019

MBI

**“SHKRIRJEN E KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE (KIZ)
AKTUAL, TË ZGJEDHUR ME VSA NR. 19, DATË 18.03.2016 DHE SHPALLJEN E
ZGJEDHJEVE TË REJA PËR ANËTAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ), NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 16.01.2019, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 19, datë 18.03.2016 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”; Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 322 prot., datë 14.01.2019 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018” (protokolluar në Institutin tonë me nr. 86 prot., datë 16.01.2019), ka vërejtur se Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), nuk ka kuorumin e duhur për të vazhduar funksionin e tij, pasi 2/3 e anëtarëve të komisionit janë larguar (mbarim studimesh dhe largim nga detyra pranë UART) dhe për këtë arsye,

VENDOSI:

1. Shkrirjen e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), aktual në Universitetin e Arteve, të zgjedhur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 19, datë 18.03.2016.
2. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, bazuar në Kreun II, neni 6, pika 1 të Rregullores së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016.
3. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i ri që do të krijohet në Universitetin e Arteve, bazuar në nenin 26 të Rregullores së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016, do të mandatohet të funksionojë deri në zgjedhjet e reja që do të zhvillohen në Universitetin e Arteve.
4. Kandidatët të cilët do të konkurrojnë (vet-kandidohen), për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, do të dorëzojnë dokumentat pranë Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik, në zyrën e Burimeve Njerëzore në Rektorat.



5. Afati për dorëzimin e dokumentave është deri më ditën e Martë, datë 22.01.2019 ora 16:00.
6. Mbas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, Sekretariati Teknik i Senatit Akademik, të paraqesë listën e kandidatëve të regjistruar Senatit Akademik, bazuar në Kreun II, neni 6, pika 1, shkronja a të Rregullores së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016.
7. Ky vendim ti dërgohet Fakulteteve të UART për shpallje.
8. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
9. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

SEKRETARIATI TEKNIK I SENATIT AKADEMIK

E. Plaku

T. Kamberi

Prof. Asoc. ALBES PUSHA